

VENDIM
Nr. 26, datë 20.1.2016

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 538, DATË 26.5.2009, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR LICENCAT DHE LEJET QË TRAJTOHEN NGA APO NËPËRMJET QENDRËS KOMBËTARE TË LICENCIMIT (QKL) DHE DISA RREGULLIME TË TJERA NËNLIGJORE TË PËRBASHKËTA”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 15 e 36, të ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në aneksin 1, që i bashkëlidhet vendimit nr. 538, datë 26.5.2009, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në shkronjën “b”, të pikës 2, të nënkategorisë VII.5, emërtimi “Për ushtrimin e veprimtarisë së tërheqjes së mbetjeve të ngurta dhe vajore në Portin Detar të Durrësit dhe në radën përkatëse, me kodin VII.5.2” zëvendësohet me emërtimin “Për ushtrimin e veprimtarisë së tërheqjes së mbetjeve të ngurta dhe vajore në Autoritetin Portual Durrës, Porto Romano dhe në radat e tyre përkatëse, me kodin VII.5.2”.

2. Në shkronjën “c”, të pikës 2, të nënkategorisë VII.5, emërtimi “Për ushtrimin e veprimtarisë së tërheqjes së mbetjeve të ngurta dhe vajore në portet detare të Vlorës, Shëngjinit, Sarandës dhe në radat përkatëse, me kodin VII.5.3” zëvendësohet me emërtimin “Për ushtrimin e veprimtarisë së tërheqjes së mbetjeve të ngurta dhe vajore në portet e tjera detare të Republikës së Shqipërisë dhe në radat e tyre, me kodin VII.5.3”.

3. Pas shkronjës “e”, të pikës 2, të nënkategorisë VII.5, shtohen shkronjat “ë” dhe “f”, me përmbajtjen, si më poshtë vijon:

“ë) “Për ushtrimin e veprimtarisë së ormexhimit”, me kodin VII.5.6;

f) “Për ushtrimin e veprimtarisë së furnizimit me karburant, për konsum, të anijeve në porte dhe në rada”, me kodin VII.5.7.”.

Pika 3 e nënkategorisë VII.5, ndryshon me këtë përmbajtje:

“3. Licencat e nënkategorive VII.5.1, VII.5.2, VII.5.3, VII.5.4, VII.5.5, VII.5.6 dhe VII.5.7 trajtohen sipas grupit III. Dokumentet provuese e shoqëruese, që dorëzohen nga kërkuesi, kuptimi i llojit të veprimtarive, institucioni tjetër, procedura e shqyrtimit të kërkesës prej tij dhe afatet për t’iu përgjigjur QKL-së për një kërkesë që ka kaluar fazën e parë nga QKL-ja, për nënkategoritë VII.5.1, VII.5.2, VII.5.3, VII.5.4, VII.5.5, VII.5.6 dhe VII.5.7, janë ato respektive, të përcaktuara në ligjin nr. 9251, datë 8.7.2004, “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama